

Kabineti i Kryetarit

Për ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave, Kryetari ndihmohet nga funksionarët ndihmës në përbërje të Kabinetit

Kabineti i Kryetarit përbëhet nga:

- a) Drejtori i Kabinetit;
- b) Këshilltari;
- c) Sekretari i Kryetarit

Drejtori i Kabinetit është funksionar i lartë ndihmës dhe ka këto detyra:

- 1) Drejton, koordinon dhe është përgjegjës për punën e kabinetit përpara Kryetarit të KD-së;
- 2) Ndjek përgatitjen e korrespondencës kryesore dhe të rëndësishme në adresë të Kryetarit dhe detyrave të lëna nga ana e tij;
- 3) Merr masat e duhura organizative lidhur me parashtrimin në kohë të materialeve apo njoftimeve që i paraqiten Këshillit Drejtues për miratim.;
- 4) Bashkëpunon me drejtuesit e strukturave organizative të AKEP për realizimin e detyrave të ngarkuara;
- 5) Në bashkëpunim me strukturën e Integritit në AKEP përgatit dhe siguron mbarëvajtjen e takimeve zyrtare të Kryetarit të KD-së brenda dhe jashtë vendit;
- 6) Merr masat për zbatimin e veprimtarisë protokollare të Kryetarit të KD

Këshilltari është funksionar i lartë ndihmës dhe kryen këto detyra:

1. Sipas çështjeve që mbulon, ndihmon drejtpërdrejtë Kryetarin në ushtrimin e funksioneve dhe detyrave.
2. “Sipas nevojës, Kryetari ngarkon Këshilltarin për të shfaqur në rrugë zyrtare mendimet, keshillat, opinionet dhe sugjerimet e tij për çështje të rëndësishme”.
3. Kur Kryetari e gjykon të nevojshme, për probleme që kanë të bëjnë me marrëdhënie të brendshme në AKEP dhe jashtë tij me organizma e institucione të ndryshme, i kërkon Këshilltarit të shprehë qëndrimin e tij, ose të përgatisë përgjigjet që kërkohen, a p o ti trajtojë hollësisht një d okument me interes për AKEP-in.
4. Këshilltari, nëpërmjet dokumentacionit që i vihet në dispozicion nga Kryetari, por dhe nëpërmjet bashkëpunimit që realizon me iniciativën e tij me drejtorite, azhurnohet me problemet

më të rëndësishme që AKEP-i është obliguar për t'i zgjidhur në funksion të kompetencave dhe detyrimeve ligjore. Në mënyrë të veçante punon sipas një programi të caktuar për t'u azhornuar me përvojën e rregullatorëve homolog dhe jep rekomandimet e veta për implementimin e kësaj përvoje nga AKEP.